



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.41, datë 28.08.2025

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE NGA BASHKIA SKRAPAR PËR
SHTETASIN HYSEN ÇOLLAKU”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.08.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “ Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendim me nr.5, datë 07.02.2025 “Për miratimin e detajimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 në vitin 2025, për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj” për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kurim për shtetasin Hysen Çollaku;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndihmës financiare në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shtetasin Hysen Çollaku.
2. Vlera prej 50 000 (pesëdhjetë) lekë, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602,zëri shpenzime operative administrate, në programin buxhetor administrim, planifikim, menaxhim.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstënim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

